

Mbetjet e Ngurta Urbane

Metadate Referenciale në format Euro SDMX Metadata Structure

(ESMS)

INSTAT

Metadate Referenciale

1. Kontakt.....	2
2. Përditësimi i metadatave	2
3. Paraqitja statistikore.....	2
4. Njësia matëse	4
5. Periudha e referencës	4
6. Mandati institucional.....	4
7. Konfidencialiteti	5
8. Politika e botimit.....	6
9. Shpeshësia e shpërndarjes.....	6
10. Aksesimi në të dhëna dhe qartësia	6
11. Menaxhimi i cilësisë	7
12. Rëndësia.....	7
13. Saktësia dhe besueshmëria.....	8
14. Afatet kohore dhe përpikmëria	8
15. Kohëzotuesia dhe Krahueshmëria.....	9
16. Kostoja dhe ngarkesa	9
17. Rishikimi i të dhënave.....	9
18. Përpunimi statistikor	10
19. Komente.....	10
Aneks	10

1. Kontakt	
1.1. Institucioni i kontaktit	INSTAT, Instituti i Statistikave
1.2. Njësia e kontaktit	Sektori i Statistikave të Mjedisit dhe Pyjeve, Drejtoria e Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit
1.3. Personi i kontaktit	Benard Shalca
1.4. Funkzioni i personit të kontaktit	Specialist, Sektori i Statistikave të Mjedisit dhe Pyjeve
1.5. Adresa postare	Rr. Vllazën Huta, Nd.35, H.1 Njësia Administrative Nr.2, 1017 Tiranë.
1.6. Adresa elektronike (e-mail)	bshalca@instat.gov.al
1.7. Numri i telefonit	+(355) 4 233356 / 233/ 240
1.8. Numri i faksit	+355 4 2228300
2. Përditësimi i metadatave	
2.1. Çertifikimi i fundit i metadatës	07.10.2021
2.2. Publikimi i fundit i metadatës	07.10.2021
2.3. Përditësimi i fundit i metadatës	07.10.2021
3. Paraqitja statistikore	
3.1. Përshkrimi i të dhënave	<p>Mbetje të ngurta urbane, sipas përcaktimeve në legjislacionin Evropian, konsiderohen çdo substancë e ngurtë ose objekt që zotëruesi i tyre është i interesuar t'i braktisë dhe dëshiron ose është i detyruar t'i hedhë ato.</p> <p>Statistikat mbi Mbetjet e Ngurta Urbane në Shqipëri mbështeten në të dhëna administrative të marra drejtpërsëdrejti nga Njesitë Bashkiake. Në Shqipëri Mbetjet e Ngurta Urbane hidhen në kazanët e grumbullimit të mbetjeve përgjithësisht të pandara sipas llojit dhe në shumë raste hidhen po aty edhe mbetjet industriale, që rezultojnë nga prodhime dhe shërbime të subjekteve të vogla biznesi në territorin urban.</p>
3.2. Sistemi i klasifikimit	<p>Klasifikimi i përdorur në Statistikat e Mbetjeve të Ngurta Urbane i referohet klasifikimeve dhe përkufizimeve sipas rregulloreve përkatëse të BE-së:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rregullorja e Komisionit European Nr. 782/2005, që përcakton formatin e detyrueshëm për transmetimin e rezultateve në Statistikat e Mbetjeve.

	<ul style="list-style-type: none"> • Rregullorja Nr. 2150/2002 mbi “Statistikat e mbetjeve”. • NACE Rev. 2. Klasifikimi statistikor i veprimtarive ekonomike.
3.3. Mbulimi i sektorit	<p>Informacioni statistikor mbulon të dhënat mbi sasinë e mbetjeve të menaxhuara nga Njesitë Bashkiake të shtrira në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas aktivitetit ekonomik të grupuara në kategoritë e mëposhtme: NVE Rev2 respektivisht ne NVE.01_03, 04_09, 10_12, 13_15, 16, 17_18, 19, 20_22, 23, 24_25, 26_30, 31_33, 34_35, 36+37+ 38 + 39, 41_43.</p>
3.4. Koncepte statistikore dhe përkufizime	<p>Mbetje të menaxhuara me fonde publike në total dhe referuar banorëve rezidentë janë: Mbetjet të cilat menaxhohen nën kujdesin e organeve të pushtetit vendor, financuar si shërbime nga buxheti i tyre për banorët vendas dhe të tjerë rezidentë në territorin e tyre administrativ.</p> <p>Sasia e mbetjeve të menaxhuara ndarë sipas burimeve kryesore gjeneruese është: Sasia totale e mbetjeve të menaxhuara ndarë në mbetje të ngurta urbane, të cilat janë mbetje familjare dhe ato të shërbimeve komunitare, dhe mbetjet industriale të cilat depozitohen dhe për pasojë menaxhohen bashkë me mbetjet urbane.</p> <p>Shkalla e mbulimit të popullatës rezidente me shërbime komunitare për menaxhimin e mbetjeve urbane është: Sasia në % e popullatës, me banim të përhershëm dhe të përkohshëm në një territor të caktuar, për mbetjet e të cilëve ofrohet shërbimi i duhur në të gjitha fazat e menaxhimit të tyre, financuar nga fondet publike.</p> <p>Përbërja relative e mbetjeve të menaxhuara sipas materialeve dominuese përkundrejt totalit është: Përqindja në peshë që zë lloji i mbetjes së emërtuar përkundrejt sasisë totale të mbetjeve.</p> <p>Trajtimi i mbetjeve në sasi dhe përqindje sipas mënyrave kryesore të trajtimit shpreh destinacionin final të mbetjeve, grupuar sipas mënyrave standarde të trajtimit.</p> <p>Mbetjet totale të gjeneruara në shkallë vendi dhe mbetjet të pa menaxhuara me fonde publike janë: Mbetjet urbane të menaxhuara me fonde publike dhe mbetjet që menaxhohen nga vetë burimet gjeneruese privatisht. Mbetjet që menaxhohen privatisht nga burimet gjeneruese rezultojnë si deduksion matematik mes mbetjeve të menaxhuara për banor dhe shkallës së mbulimit të banorëve rezidentë me shërbime komunitare për mbetjet.</p> <p>Struktura e subjekteve që menaxhojnë mbetje nënkupton përqindjen që zënë subjektet e klasifikuara sipas statusit të tyre juridik në totalin e subjekteve që kanë menaxhuar mbetje në vitet përkatëse.</p> <p>Mbetjet totale të gjeneruara përbejnë sasinë teorike të mbetjeve urbane prodhuar nga aktiviteti njerëzor në vitin përkatës. Ky tregues i referohet mbetjeve të menaxhuara në zonat ku ky aktivitet kryhet si shërbim komunitar ndaj publikut dhe sasisë tjetër të mbetjeve të cilat menaxhohen nga vetë banorët pasi nuk mbulohen nga shërbimet publike për mbetjet. Sasia e mbetjeve totale të gjeneruara në këtë rast vjen si kalkulim teorik i mbetjeve totale të gjeneruara nga banorët, bazuar në treguesin e mbetjeve të menaxhuara për banor rezident në vit dhe në shkallën e mbulimit të banorëve me shërbime për mbetjet në vitin përkatës.</p>

3.5. Njësia statistikore	Njësia statistikore e vrojtuar është Njësia Bashkiake.
3.6. Popullata statistikore	<p>Të dhënat mbi Mbetjet e Ngurta Urbane përfshijnë të gjithë informacionin e mbledhur nga Njësia Bashkiake në të gjithë territorin e Shqipërisë, në të cilin jepen informacion statistikor për:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mbetje të menaxhuara me fonde publike në total dhe referuar banorëve rezidentë sipas viteve. • Sasia e mbetjeve të menaxhuara ndarë sipas burimeve kryesore gjeneruese. • Shkalla e mbulimit të popullatës rezidente me shërbime komunitare për menaxhimin e mbetjeve urbane. • Përbërja relative e mbetjeve të menaxhuara sipas materialeve dominuese përkundrejt totalit. • Trajtimi i mbetjeve në sasi dhe përqindje sipas mënyrave kryesore të trajtimit. • Mbetjet totale të gjeneruara në shkallë vendi dhe mbetjet e pa menaxhuara me fonde publike.
3.7. Zona e referencës	Statistikat mbi Mbetjet e Ngurta Urbane mbulojnë të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
3.8. Mbulimi në kohë	Të dhënat statistikore për Mbetjet e Ngurta Urbane datojnë që nga viti 2013.
3.9. Periudha bazë	Nuk aplikohet.
4. Njësia matëse	Njësitë matëse për statistikave të Mbetjeve të Ngurta Urbane janë Milionë ton dhe përqindje.
5. Periudha e referencës	Periudha e referencës për statistikave të Mbetjeve të Ngurta Urbane është vjetore. Ky raport i përket vitit referencë 2020.
6. Mandati institucional	
6.1. Akte ligjore dhe marrëveshje të tjera	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Baza ligjore në nivel kombëtar për prodhimin e Statistikave mbi Mbetjet e Ngurta Urbane janë: <ul style="list-style-type: none"> • Ligji Nr. 17/2018 "Për Statistikat Zyrtare" • Programi Kombëtar i Statistikave Zyrtare 2017-2021 ➤ Klasifikimet dhe përkufizimet sipas rregulloreve përkatëse të BE-së: <ul style="list-style-type: none"> • Rregullorja Nr. 2150/2002 mbi "Statistikat e mbetjeve" • Direktiva e Këshillit të Europës Nr. 2008/98/EC për mbetjet dhe raportimin e detyrueshëm të statistikave për mbetjet. • Rregullorja e Komisionit Europian Nr. 782/2005, që përcakton formatin e detyrueshëm për transmetimin e rezultateve në statistikave të mbetjeve. • Rregullorja Komisionit Europian Nr. 783/2005, Shtojca II për rregulloren e mbetjeve.

	<ul style="list-style-type: none"> • Direktiva e Këshillit të Europës Nr. 2150/2002 për “Kriteret e duhura të vlerësimit të cilësisë dhe përmbajtjen e raporteve të cilësisë për statistikat e mbetjeve”. • Rregullorja e Komisionit European Nr. 849/2010 për “Menaxhimin e mbetjeve urbane”. • Manuali i Statistikave për Mbetjet 2013 i amenduar, Publikimi i Eurostat, viti 2013. • NACE Rev. 2. Klasifikimi statistikor i veprimtarive ekonomike.
6.2. Shkëmbimi i të dhënave	Statistikat administrative e mbetjeve të ngurta urbane transmetohen në EUROSTAT, nëpërmjet platformës eDAMIS.
7. Konfidencialiteti	
7.1. Konfidencialiteti - politika	<p>Të dhënat e mbledhura konsiderohen rreptësisht konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore e kërkime shkencore në përputhje me Ligj Nr. 17/2018 PËR STATISTIKAT ZYRTARE, si dhe Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Mbrojtja e të Dhënave Personale". Neni 31 i ligjit për statistikat zyrtare përcakton qartë që i gjithë informacioni statistikor i mbledhur nga INSTAT është konfidencial dhe mund të përdoret ose botohet vetëm në tabela përmbledhëse të tilla që nuk identifikojnë njësinë burim të informacionit. Identifikim i drejtpërdrejtë quhet kur një njësi statistikore identifikohet drejtpërdrejt nga emri, adresa ose ndonjë numër identifikimi i njohur zyrtarisht. Kur përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshëm.</p>
7.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënave	<p>INSTAT mbron dhe nuk shpërndan të dhënat që ka mbledhur ose që ka akses, të cilat mundësojnë identifikimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të njërive statistikore. INSTAT ndërmerr të gjitha masat e duhura për të parandaluar dhe bërë të pamundur identifikimin e njërive statistikore përmes mjeteve teknike të tjera që mund të përdoren nga palët e treta. Të dhënat statistikore që mund të bëjnë të mundur identifikimin e njësisë statistikore, shpërndahen nga INSTAT vetëm në rast se:</p> <p>a) Këto të dhëna janë trajtuar, siç është përcaktuar në mënyrë të veçantë në Rregullore, këto të dhëna janë trajtuar në mënyrë të atillë, sa nuk krijon paragjykim në lidhje me konfidencialitetin statistikor; ose</p> <p>b) Njësia statistikore ka dhënë miratimin përkatës për bërjen publike të të dhënave;</p> <p>Të dhënat konfidenciale i përcillen INSTAT-it vetëm për qëllime statistikore dhe vetëm personat që kanë të drejtë akses tek to, mund të punojnë me to. Çështjet dhe problemet në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit statistikor verifikohen dhe trajtohen nga stafi i INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi, janë të përcaktojë shkallën e detajimit që mund të shpërndahet dhe të bëhet publike nga INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi janë të rekomandojë se: në cilin nivel detajimi mund të shpërndahen të dhënat statistikore, në mënyrë që identifikimi i drejtpërdrejtë ose indirekt, i njësisë statistikore të vrojtuar të mos jetë i mundur; kriteret e anonimizimit për mikrodatat që u janë dhënë përdoruesve; dhënia e</p>

	hyrjes për hulumtuesit në të dhëna konfidenciale për qëllime shkencore.
8. Politika e botimit	
8.1. Kalendarin e publikimeve	Njoftimet në lidhje me shpërndarjen e statistikave janë botuar në kalendarin e publikimit, i cili është në dispozicion në faqen e internetit. Njoftime dhe vonesat janë para-njoftuar në këtë kalendar. Në rastin e vonesave specifikohet data e publikimit të ardhshëm si dhe shpjegimi lidhur me arsyet e vonesave.
8.2. Aksesin në kalendarin e publikimeve	Kalendari i publikimeve mund të aksesohet online në faqen e internetit të INSTAT.
8.3. Aksesin i përdoruesve	Në përputhje me nenin 34 të Ligji Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare, statistikave zyrtare shpërndahen në mënyrë që të gjithë përdoruesit të kenë të drejtë të menjëhershme dhe të barabartë dhe të përdoren të gjitha format e mundshme të mediave. INSTAT dhe agjencitë statistikore, që kanë në program përgjegjësitë e shpërndarjes, kërkojnë të plotësojnë çdo kërkesë të ndonjë organizate ose individit për të dhëna të pabotuara ose analiza specifike. Kanalet nga të cilat përdoruesit mund të marrin rezultatet e publikimit për “Mbetjet e Ngurta Urbane” janë si më poshtë: <ol style="list-style-type: none"> 1. Website – online release 2. Kërkesat e shkruara 3. Publikimi 4. Seksioni Kërkesa të dhënash.
9. Shpeshësia e shpërndarjes	Publikimi i të dhënave mbi “Mbetjet e ngurta urbane” realizohet me frekuencë vjetore.
10. Aksesin në të dhëna dhe qartësia	
10.1. Njoftim për media	Njoftim për media përmban informacion në lidhje me treguesit kryesorë si: trajtimi i mbetjeve, struktura e subjekteve etj. Formatin e njoftimit për shtyp përcaktohet nga sektori i publikimit, i cili vendos dhe datën e publikimit. Njoftimi për shtyp për Statistikat Mbetjeve të Ngurta Urbane publikohet online në faqen e internetit të INSTAT.
10.2. Publikime	Përdoruesit mund t'i gjejnë rezultatet në faqen e internetit të INSTAT në temën: <ul style="list-style-type: none"> • "Mbetjet e Ngurta Urbane 2020"
10.3. Baza e të dhënave on-line	Të gjitha informacionet vihen në dispozicion në dy gjuhë Shqip dhe Anglisht. Që nga viti 2011, përmes sistemit Pc-Axis. Gjithashtu në këtë faqe interneti ka një shpjegim të thjeshtë metodologjik. Bazën e të dhënave e aksesoni në linkun më poshtë: Databaza Statistikore
10.4. Aksesin në të dhënat mikro	Të dhënat mbi Statistikat e Mbetjeve të Ngurta Urbane janë të dhëna administrative dhe si të tilla niveli më i detajuar i të dhënave që merren është në nivel bashkie. Pra, INSTAT nuk disponon të dhëna në nivel mikro për Statistikat

	e Mbetjeve të Ngurta Urbane.
10.5. Të tjera	Përdoruesit mund të dërgojnë kërkesa të tjera specifike nëpërmjet një seksioni të dedikuar për Kontakt .
10.6. Dokumentimi i metodologjisë	Metodologjia mbi Mbetjeve të Ngurta Urbane është e bazuar në manualët dhe rregulloret e EUROSTAT. Një shpjegim i shkurtër lidhur me përkufizimet, konceptet kryesore dhe shpjegimet metodologjike për përdoruesit publikohet në njoftimin për shtyp dhe publikimet mbi Mbetjeve të Ngurta Urbane. Informacione shtesë u jepen përdoruesve të brendshëm kur është e nevojshme. Në faqen e INSTAT ka një seksion lidhur me Metodologjinë mbi Mbetjet e Ngurta Urbane.
10.7. Dokumentimi i cilësisë	Sektori i Statistikave të Mjedisit dhe Pyjeve dokumenton të gjithë procesin e punës dhe procedurat mbi statistikat e Mbetjeve të Ngurta Urbane për qëllimet e brendshme.
11. Manaxhimi i cilësisë	
11.1. Sigurimi i cilësisë	INSTAT është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në ligjin “Për Statistikat Zyrtare, Nr. 17/2018, INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të pranura ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice). INSTAT për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: paanshmëria, cilësia e proceseve dhe produkteve statistikore, orientimi për përdoruesit, orientimi për punonjësit, efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës së të intervistuarve.
11.2. Vlerësimi i cilësisë	Të dhënat për Statistikat e Mbetjeve Urbane krahasohen me të dhënat e mbledhura me vitet e mëparëshme për të dalluar nëse ka koherencë të dhënash apo nëse ka pasur ndryshime të mëdha. Në rast ndryshimesh, të dhënat administrative përdoren për të konfirmuar situatën e rasteve kur hasen ndryshime të mëdha të sjelljes së një viti me vitet e tjera.
12. Rëndësia	
12.1. Nevojat e përdoruesit	Përdoruesit e Statistikave mbi Mbetjet e Ngurta Urbane ndahen në përdorues të brendshëm dhe të përdorues të jashtëm. <ul style="list-style-type: none"> ➤ Përdorues të jashtëm <ul style="list-style-type: none"> • Institucione të administratës publike • Universitetet • Organizatat jo fitimprurëse kombëtare dhe ndërkombëtare • Bizneset

	<ul style="list-style-type: none"> • Kërkues, student edhe të tjerë grupe të ngjashme. <p>➤ Përdorues të brendshëm</p> <ul style="list-style-type: none"> • Drejtoria e Llogarive Kombëtare • Drejtoria e Statistikave Ekonomike • Drejtoria e Statistikave Sociale • Drejtoria e Sektorit Real <p>Të cilët përdorin statistikën mbi Mbetjet e Ngurta Urbane si input në punën e tyre.</p>
12.2. Kënaqësia e përdoruesit	<p>Klikime (Page Views) në lidhje me Statistikat e Mjedisit për vitin 2020 janë rreth 6,690 klikime.</p> <p>Gjatë 2020 INSTAT ka kryer vrojtimin për matjen e kënaqësisë së përdoruesve nga publikimet e INSTAT. Rezultatet e vrojtimit tregojnë se cilësia e përgjithshme e “Statistikave të Mjedisit” është vlerësuar me 3.64 (72.8%) nga një shkallë prej 1 (shumë e dobët) në 5 (shumë e mirë).</p> <p>INSTAT organizon çdo vit Anketën e Kënaqësisë së Përdoruesve.</p>
12.3. Plotshmëria	<p>Plotshmëria e të dhënave për Statistikat e Mbetjeve të Ngurta Urbane gjykohet duke krahasuar cilësinë dhe sasinë e treguesve të mbuluar në INSTAT nga ato të rregulloreve të ndjekura.</p> <p>Niveli i plotshmërisë të treguesve në nivel të agreguar është në përputhje me rregulloren: “Rregullorja e Komisionit Evropian Nr. 782/2005”, dhe si të tillë sasia e treguesve që kërkohen nga EUROSTAT raportohen në shkallën 95%.</p>
13. Saktësia dhe besueshmëria	
13.1. Saktësia e përgjithshme	<p>Në përgjithësi, të dhënat janë kontrolluar me vitet e mëparshme për të identifikuar ndonjë ndryshim të rëndësishëm në ecurinë e të dhënave. Në rastet kur hasen ndryshime, INSTAT njofton Ministrinë e Mjedisit për të vënë në dijeni rreth gjetjeve të konstatuara në mënyrë që të realizohet korrigjimi i këtyre të dhënave nëse shihet i nevojshëm ose të konfirmohen në mënyrë zyrtare.</p>
13.2. Gabim i kampionimit	<p>Nuk aplikohet sepse të dhënat bazohen në burime administrative.</p>
13.3. Gabim jo i kampionimit	<p>Rishikimi i të dhënave ndodh vetëm në rast se institucionet përkatëse rishikojnë të dhënat e dërguara në INSTAT për efekt përditësimi apo ndonjë gabim të mundshëm human. Nëse institucionet përkatëse rishikojnë të dhënat e dërguara në INSTAT, atëherë në publikimin më të afërt do të pasqyrohen këto ndryshime dhe do të jepet një informacion i shkurtër sqarues për përdoruesit. Gabimet e jo-kampionimit trajtohen bazuar në politikën e Trajtimit të Gabimeve.</p>
14. Afatet kohore dhe përpikmëria	
14.1. Afatet kohore	<p>Rezultatet për Statistikat e Mbetjeve të Ngurta Urbane janë publikuar në faqen e internetit të INSTAT 264 ditë pas përfundimit të periudhës referuese (T + 264</p>

	<p>ditë). Periudha referuese e rezultateve të Mbetjeve të Ngurta Urbane është 31 Dhjetori 2020.</p> <table border="1" data-bbox="432 203 903 322"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>12/31/2020</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>9/21/2021</td> </tr> <tr> <td>Afatet kohore</td> <td>264</td> </tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2020	Data e publikimit	9/21/2021	Afatet kohore	264		
Periudha referuese	12/31/2020								
Data e publikimit	9/21/2021								
Afatet kohore	264								
14.2. Përpikmëria	<p>Të dhënat për Statistikat e Mbetjeve të Ngurta Urbane, publikohen bazuar në kalendarin e publikimeve. Publikimi i të dhënave mbi Mbetjet e Ngurta Urbane, ka qenë i përpiktë në kohë në masën 100% të publikime të kryera.</p> <table border="1" data-bbox="448 495 895 640"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>12/31/2020</td> </tr> <tr> <td>Data e shpallur</td> <td>9/21/2021</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>9/21/2021</td> </tr> <tr> <td>Vonesa në kohë</td> <td>0</td> </tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2020	Data e shpallur	9/21/2021	Data e publikimit	9/21/2021	Vonesa në kohë	0
Periudha referuese	12/31/2020								
Data e shpallur	9/21/2021								
Data e publikimit	9/21/2021								
Vonesa në kohë	0								
15. Koherenca dhe Krahasueshmëria									
15.1. Krahasueshmëria gjeografike	Të dhënat mbi Statistikat e Mbetjeve të Ngurta Urbane janë gjithë përfshirëse, ato prodhohen në nivel vendi. Statistikat krahasohen sipas shpërndarjes gjeografike.								
15.2. Krahasueshmëria kohore	<p>Të dhënat për Mbetjet e Ngurta Urbane datojnë që nga viti 2013 referuar databazës statistikore duke siguruar një krahasueshmëri kohore prej 8 vitesh (CC2=Jlast-Jfirst+1=8).</p> <p>Të dhënave ju bëhen kontrole të vazhdueshme për të garantuar krahasueshmërinë e tyre në seri kohore.</p>								
15.3. Koherenca e ndërthurjes së fushave	Nuk aplikohet.								
15.4. Koherenca e brendshme	Konsistenca e brendshme e të dhënave kontrollohen para se të finalizohen rezultatet për publikim. Kontrollohen gjithashtu lidhjet midis variablave dhe koherenca në seri të ndryshme.								
16. Kostoja dhe ngarkesa	<p>Stafi i përfshirë në përgatitjen e Statistikave të Mbetjeve të Ngurta Urbane pranë sektorit të Statistikave të Mjedisit dhe Pyjeve është: 3 punonjës të sektorit të statistikave të mjedisit dhe pyjeve pranë zyrave qendrore të INSTAT, 1 punonjës IT pranë zyrave qendrore të INSTAT.</p> <p>Të dhënat mblidhen drejt përsëdrejti nga njësitë e bashkive në të gjithë territorin e vendit, të dhënat dërgohen në INSTAT nëpërmjet pyetësorit elektronik online.</p>								
17. Rishikimi i të dhënave									
17.1. Politika e rishikimit	<p>Politikat e rishikimit bëhen në përputhje me politikën e rishikimit si dhe politikën e trajtimit të gabimeve të vendosura nga INSTAT. Për më shumë referohuni:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Politika e revizionimit • Politika e trajtimit të gabimeve 								

17.2. Praktika e rishikimit	Nuk janë kryer rishikime të të dhënave mbi “Statistikat e Mbetjeve të Ngurta Urbane” për vitin 2020, subjekti i këtij raporti.
18. Përpunimi statistikor	
18.1. Burimi i të dhënave	<p>Për statistikën mbi Mbetjet e Ngurta Urbane, INSTAT përdor informacionin e siguruar nga burime të ndryshme administrative siç janë Njesitë Bashkiake. Të dhënat e përdorura mund të jenë prodhim statistikor i vetë INSTAT ose i institucioneve të ndryshme kombëtare si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ministria e Mjedisit, • Agjencia Kombëtare e Mjedisit, • Drejtoritë e mjedisit në Bashki, • Instituti i Shkencave të tokës dhe të tjera. <p>Duke krahasuar këto burime me njëra-tjetrën, arrihet të prodhohet një pamje e vetme e të dhënave mbi Mbetjet e Ngurta Urbane.</p>
18.2. Shpeshësia e grumbullimit të të dhënave	Të dhënat e Mbetjeve të Ngurta Urbane grumbullohen mbi baza vjetore.
18.3. Grumbullimi i të dhënave	<p>Mbledhja e të dhënave bazohet në dy mënyra të ndryshme të mbledhjes së informacionit:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mbledhja e të dhënave administrative nëpërmjet rekordeve administrative të institucioneve përkatëse që merren me politikën dhe mbikqyrjen e menaxhimit të Mbetjeve në Shqipëri. • Plotësimi i informacionit të kërkuar nëpërmjet web formës nga Njesitë Bashkiake.
18.4. Vlefshmëria e të dhënave	Të dhënave u janë bërë kontrolle logjike dhe matematike. Këto kontrolle kryhen gjatë të gjithë procesit të përpunimit të të dhënave, për të gjithë treguesit të cilët INSTAT publikon. Ndër metodat e verifikimit të të dhënave administrative mund të përmendim: Kontrolli për plotësinë e të dhënave, konsistenca me kalimin e kohës, korrigjimet aritmetike (nuk duhet të jenë shumë të larta), kontrollet përmbledhëse, kontrolli i serive kohore nëse ka devijime të mëdha, etj.
18.5. Përpilimi i të dhënave	Nuk aplikohet.
18.6. Rregullimi	Nuk aplikohet.
19. Komentë	
Aneks	